

Në bazë të nenit 25 të Statutit të Komunës së Deçanit, nenet 5 dhe 17 pika (f) dhe (p) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, duke u mbështetur në Rregulloren nr.02/2013 Mbi Kriteret për Krijimin e Ndërmarrjeve Publike Lokale dhe Ligjit nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.27.05.2015, nxjerrë këtë :

V E N D I M

PËR INICIMIN E PROCEDURËS MBI THEMELIMIN E NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE

I.

Inicohet procedura për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale "Higjiena Sh.A" e organizuar si Shoqëri Akcionare, sipas Ligjit mbi Shoqëritë Tregtare nr.02/L-123.

II.

Themelues i Ndërmarrjes Publike Lokale "Higjiena Sh.A" është Komuna e Deçanit si aksionare me 100% të kapitalit themeltar.

III.

Komuna e Deçanit nëpërmes Komisionit Komunal të Aksionarëve do t'i ushtroj të drejtat e saj të aksionarit.

IV.

Selia e Ndërmarrjes Publike Lokale "Higjiena Sh.A" është në rrugën e UÇK-së pa nr.

V.

Me një Vendim të veçantë Kuvendi i Komunës cakton grupin punues për pëmbylljen e procedurave të nevojshme për themelimin e Ndërmarrjes Publike Lokale.



VI.

Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Kuvendi i Komunës.

01.Nr.V-4

Deçan, dt.27.05.2015

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT



Kryesuesi i Kuvendit:

Jashar Dobraj